



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 31 janar 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1477_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 25 dhe Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 1.19, Nenit 33 paragrafi 4, Nenit 39, Nenit 40 dhe Nenit 41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 08/2017 për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit të datës 13 prill 2017;
- Dispozitat e Nenit 19 të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike dhënë "Korporatës Energjetike të Kosovës" Sh.A;
- Vendimin e ZRRE-së, V_1417_2021 të datës 04.10.2021 për Hapjen e Procedurës së Tenderimit për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit;

në seancën e mbajtur më 31 janar 2022 nxori këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

- I. CAKTOHET - KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH.A** që të ushtrojë **PËRKOHËSISHT** përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (Furnizues i Garantuar).
- II.** Obligimi i caktuar në pikën I të këtij Vendimi do të ushtrohet për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh, dhe do filloj të zbatohet nga data **31 Janar 2022 deri më datën 30 Korrik 2022.**
- III.** Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar që të siguroj të gjitha shërbimet e furnizimit të përcaktuara me Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën ZRRE/Nr.12/2017 për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit, Licencën për Furnizim me energji elektrike të lëshuar nga ZRRE për Korporatën Energjetike të Kosovës dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- IV.** Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i obliguar që të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur:
 - furnizuesi i tij ka bankrotuar apo është në likuidim;
 - licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo i ka skaduar;
 - konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.



- V. Furnizimi i garantuar sipas pikës IV nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.
- VI. Kostot e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të përcaktohen në përputhje me Nenin 6 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

ARSYETIM

- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në përputhje me dispozitat e Nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike ka nxjerrë Vendimin Nr.V_1417_21 të datës 04.10.2021 për Hapjen e Procedurës së Tenderimit për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
 - Në Ftesën për shprehje të interesit për të aplikuar në Tenderin për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit i publikuar me datë 12.10.2021 në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, i është përgjigjur vetëm një aplikues.
 - Pasi që nuk janë plotësuar kriteret bazë të përcaktuar me Nenin 4 par. 1 të Rregullës Nr. 08/2017 për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, dhe atë: *"Konkurrenca për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të konsiderohet se është e vlefshme nëse jo më pak se dy (2) tenderues kanë përmbushur kriteret përkatëse të pranueshmërisë."*, ZRRE me njoftim publik ka bërë anulimin e Tenderit.
 - Si rezultat i kësaj më lartë (dështimin/anulimit të tenderit) janë plotësuar të gjitha rrethanat që Rregullatori ta caktojë Furnizuesin e përkohshëm ashtu siq përcaktohet në Ligjin për Energjinë Elektrike, Nenin 40/4: *"Rregullatori do të caktojë një furnizues që përkohësisht të ushtrojë funksionin e furnizuesit të mundësisë së fundit, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, periudhë kjo brenda së cilës do të zhvillohet tenderi i ri."*
 - Bordi i ZRRE-së, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi ka vlerësuar se "KEK" sh.a i Licencuar për furnizim me energji elektrike ka deklaruar se do ta pranojë këtë përgjegjësi (nëse i vendoset nga ZRRE); ka përvojën për ta ushtruar këtë përgjegjësi; posedon softverin për ushtrimin e këtij aktiviteti; posedon personel profesional për ta ushtruar këtë përgjegjësi; ka gjendjen e shëndoshë financiare, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

“Korporatës Energjetike të Kosovës” sh.a (KEK), dhe
Aktivit të Rregullatorit

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Rëzullahu, Kryesues

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Geni Buçaj, Anëtar